



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

A.nr.750/13

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Anita Nikçi- Morina dhe me zytaren ligjore Ilirjana Makolli në konfliktin administrativ të paditësit- Instituti për Studime të Avancuara GAP me seli ne Prishtinë, që përfaqësohet nga Nora Latifi Jashari dhe Agron Dema (këtu e tutje “Paditës”) kundër të paditurës /Ministria e Zhvillimit Ekonomik në Prishtinë, baza juridike kërkesë për qasje ne dokumente zyrtare, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur në prani të paditëses dhe në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur, me dt.12.12.2017 merr këtë:

AKT GJYKIM

Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e Instituti për Studime të Avancuara GAP.

Detyrohet i padituri Ministria e Zhvillimit Ekonomik në Prishtinë që brenda 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, ti lejohet paditësit Instituti për Studime të Avancuara GAP me seli ne Prishtine, te ketë qasje në dokumentet publike qe lidhen me procesin e privatizimit te KED-se dhe Ofertimit te Projektit “Kosova e Re “

Arsyetim

Paditësi, Instituti për Studime të Avancuara GAP, mbështetur nga Konsorciumi Kosovar i Shoqërisë Civile për Zhvillim të Qëndrueshëm ka kërkuar nga kjo Gjykatë vërtetimin e shkëljes së Ligjit mbi Qasjen në Dokumente Publike nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik për shkak të pretendimit se I është mohuar e drejta për qasje në dokumente publike në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Njësinë Implementuese të Projektit KEDS (Rrjeti i Distribucionit dhe Shpërndarjes së KEK), që është segment i MZHE-së, duke kërkuar qasje në planin afarist të KEDS datë 25 Mars 2013.

Paditësi ka bërë kërkesën në bazë të nenit 4 të Ligjit për Qasje mbi Dokumentet Publike tek MZHE më 25 Mars 2013 për qasje në dokumente publike. MZHE është përgjigjur pozitivisht kërkesës për qasje në dokumente publike duke lejuar qasjen në dokumentet publike sipas kërkesës së Institutit GAP por dokumenti i kërkuar është ofruar vetëm për tu pare (pra në shiqim) në ndërtesën e MZHE-së, konkretisht te Njësia Implementuese e Projektit për privatizimin e KKDFE-së dhe pala paditëse nuk i është lejuar marrja e dokumentit duke u arsyetuar se shtojcat (Schedules) të Dokumenteve të Transferit janë në formën e draftit final. Pala paditëse më pas i drejtohet me kërkesë date 26 Prill 2013 Zyres për Informim te KEK-ut e cila paditësit I ka kthyer përgjigje zyrtare se Lista e asetëve pjese integrale e Marrëveshjes për Shitje te Aksioneve, e cila është nënshkruar mes Qeverise se Republikës se Kosovës (përmes Komitetit te Privatizimit) dhe konzorciumit Cali & Lima dhe pavarësisht faktit se KEK'u është ne posedim te shënimeve te kërkuara, nuk ka te drejte te ndarjes së tyre.

Instituti GAP pas marrjes se përgjigjes zyrtare nga Zyra e Informimit ne KEK te datës 26 Prill 2013, ka informuar Zyrën për Informim pranë KEK-u se po kërkojmë listën e adeteve te KKDFE ne kohen kur kjo kompani është krijuar, dhe jo listën e aseteve te KKDFE qe është pjese e marrëveshjes Qeveri e Kosovës Limak-Calik.

Instituti GAP pretendon se i është cënuar e drejta për qasje ne dokumente publike sipas nenit 4 te Ligjit mbi Qasjen ne Dokumentet Publike dhe Nenin 3.1.3 te ligjit ne fjale pasi kërkesat zyrtare te Institutit GAP kane plotësuar te gjitha kushtet ligjorë për te garantuar qasje të papenguar në dokumente publike. Pala paditëse poashtu pretendon se kanë bërë identifikimet të sakte të kërkesës dhe njësisë institucionale qe i posedoj informatat e kërkuara.

Ligji nr. 03/l-215 për qasje në dokumente publike në nenin 2 para 1 thekson se “ky ligj zbatohet për të gjitha dokumentet që mbahen, hartohen apo pranchen nga institucionet publike”. Për më tepër sipas nenit 2 para 2 të Ligjit përcaktohet se “E drejta për qasje në dokumente realizohet në pajtim me këtë ligj, pa paragjykuar dispozitat e ligjeve, si dhe të instrumenteve ligjore ndërkombëtare, të cilat njohin të drejta më të gjëra, për qasjen në dokumente publike”.

Neni 41 i Kushtetutës së Kosovës [E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike] përcakton se “1. Secili person gëzon të drejtën të qasjes në dokumente publike. 2. Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë.”

Në çështjen nëse pala e paditur bën pjesë në kuadër të fushëveprimit të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, Gjykata gjen se ky Ligj ka përcaktuar se në kuadër të detyrimeve të përcaktuara për të siguruar qasje në dokumentet publike, në kuadër të institucioneve publike hyjnë institucionet dhe organet e pushtetit shtetëror si Qeveria dhe administrata në nivelin shtetëror, rajonal dhe local, institucionet ligjvënëse dhe gjyqësore, me kusht që kryejnë funksione administrative, sipas ligjeve të Republikës së Kosovës; personat fizik apo juridik, me kusht që të ushtrojnë autoritet administrativ, kryejnë detyra publike, apo operojnë me fonde publike sipas ligjeve të Republikës së Kosovës (bartësit privat të kompetencave publike). Në këtë rast sikurse MZHE ashtu edhe KEK hyjnë në kuadër të institucioneve që bien në fushëveprim të këtij Ligji.

Lidhur me çështjen nëse dokumenti i kërkuar përbën një dokument publik, Gjykata gjen se sipas Ligjit mbi Qasjen në Dokumentet Publike, dokument publik konsiderohet çdo dokument zyrtar "duke përfshirë por duke gjitha informatat e regjistruara ne çfarëdo forme, te hartuara apo pranuar te dhe mbajtura nga institucionet publike."

Lidhur me çështjen nëse pala e paditur ka vepruar në pajtim me kërkesat e nenit 12 të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, Gjykata gjen se kufizimi i qasjes sipas nenit 12 të Ligjit për qasje në dokumente publike ushtrohet proporcionalisht dhe vetëm për qëllime të mbrojtjes së: 1.1. sigurisë kombëtare, mbrojtjes dhe marrëdhënieve ndërkombëtare; 1.2. sigurisë publike; 1.3. parandalimit, hulumtimit dhe ndjekjes së aktiviteteve penale; 1.4. hulumtimeve disiplinore; 1.5. inspektimit, kontrollimit dhe mbikëqyrjes nga institucionet publike; 1.6. privatësisë dhe interesave të tjerë legjitim privat; 1.7, interesave komerciale dhe të tjera ekonomike; 1.8. politikave ekonomike, monetare dhe kem bimorë të shtetit; 1.9. barazisë së palëve në procedura gjyqësore dhe administrimin efikas të drejtësisë; 1.10.

mjedisit, apo, 1.11. diskutimeve brenda apo ndërmjet institucioneve publike lidhur me shqyrtimin e ndonjë çështjeje. Pala paditur nuk ka ofruar dëshmi bindëse dhe mire të arsyetuara në kuptim të nenit 12 se në cilën kategori të përjashtimeve të theksuara mbështetet ky kufizim.

Pala e paditur po ashtu vetëm ka ofruar në shikim dokumentin e kërkuar palës paditëse por Gjykata rikujton se sipas nenit 11 para 1. të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike "kur të lejohet qasja në dokument kërkuesi ka të drejtë të zgjedhë nëse do të kontrollojë origjinalin apo kopjen, ose për të pranuar një kopje të dokumentit në çfarëdo forme apo formati në dispozicion sipas zgjedhjes së tij". Gjykata gjen se pala e paditur ka refuzuar të ofroj dokumentin në formën e kërkuar duke pretenduar se disa shtojca të dokumentit të kërkuar janë ende në formë të draftit dhe nuk janë të finalizuar.

Gjykata iu referua edhe Konventës Evropiane për Mbrojtjen e te Drejtave dhe Lirive Themelore te Njeriut, e cila ne baze te nenit 22 të Kushtetutës së Republikës se Kosovës zbatohet drejtpërsëdrejti ne Kosove, nenit 10 te njëjtës ku përcaktohet se "1.cdokush ka te drejtën e lirisë se shprehjes. Kjo e drejte përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për te marre ose par te dhëna informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marre parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet qe te kërkojnë licencimin e ndërmarrjeve te transmetimit audio, kinematografik ose televiziv. 2. Ushtrimi i këtyre lirive qe përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve te parashikuara me ligj dhe qe janë te nevojshme ne një shoqëri demokratike, ne interes te sigurisë kombëtarë, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose te moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose te drejtave te tjerëve, për te ndaluar përhapjen e te dhënave konfidenciale ose për te garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor".

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e organit te paditur i cili ka konsideruar se ta dhënat e kërkuara janë akoma në formë të draftit dhe nuk janë të finalizuar. Te njëjtin pretendim gjykata e vlerëson si te pabazuar, kjo për faktin se dokumentet e tilla të institucioneve publike duhet të jenë të hapura për qytetaret e Republikës se Kosovës dhe nga ky aspekt, ata kane drejtpërsëdrejti interes te arsyeshëm te informohen lidhur me këtë përmbajtje.

Duke u bazuar ne te arsyet e dhëna me lartë gjykata ne kuptim te nenit 43, 46, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 te LKA-se, ka vendosur si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
A.nr. 750/13 dt.12.12.2017

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

Gjyqtarja
Anita Nikçi-Morina

